



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

**RREGULLORE**

**PËR**

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME TAKSI**

**Prishtinë, 2022**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c, nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 32, paragrafi 5 i Ligjit nr. 04/L - 179, për transportin rrugor, të nenit 2 të Ligjit nr. 06/L-070, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor, të nenit 15, shkronja f të Ligjit nr. 03/L-049, për financat e pushtetit lokal, Ligji nr. 05/-087, për kundërvajtje dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi këtë

## **R R E G U L L O R E**

### **PËR**

### **USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME TAKSI**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e kryerjes dhe organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Kryeqytetit, Prishtinë (në tekstin në vazhdim *Kryeqytetit*).

##### **Neni 2**

Rregullimin dhe organizimin e transportit të udhëtarëve me taksi e bëjnë Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Drejtoria e Inspeksionit.

##### **Neni 3**

Transporti taksi, është transport publik i udhëtarëve në transportin jo të rregullt (jashtëlinjor) rrugor, për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është i njohur më parë dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit, sipas çmimoreve të shërbimeve të caktuara nga Kryeqyteti.

##### **Neni 4**

Transporti taksi i udhëtarëve lejohet të kryhet me vetura më pesë (4+1) ulëse, i cili ka së paku katër (4) dyer.

## **II. KUSHTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE**

### **Neni 5**

1. Transportin e udhëtarëve me taksi mund ta ushtrojnë persona fizikë dhe persona juridikë, të cilët janë të pajisur me licencë për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore.
2. Numri i licencave të cilat do të jepen për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve, do të jetë sipas rekomandimeve të Planit të mobilitetit, të miratuar në Kuvendin e Kryeqytetit.
3. Ky numër mund të ndryshojë varësisht nga nevojat dhe zhvillimet e mëtutjeshme të Planit të mobilitetit.

### **Taksi individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik)**

### **Neni 6**

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, taksi individual (person fizik apo ndryshe edhe "taksi të Kryeqytetit"), duhet t'i plotësojë këto kushte për marrjen e licencës nga Kryeqyteti:

- 1.1. të dëshmojë se është pronar/e i/e veturës me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing), që i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje;
- 1.2. të jetë i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
- 1.3. të jetë banor/e i/e Kryeqytetit (dëshmi për vendbanim);
- 1.4. të jetë i/e pajisur me arkë fiskale, sipas vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK);
- 1.5. të jetë i/e pajisur me certifikatën që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
- 1.6. të jetë i/e pajisur me certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj).

### **Taksi kompani (Person juridik)**

### **Neni 7**

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, taksi kompani duhet t'i plotësojë këto kushte për marrjen e licencës nga Kryeqyteti:

- 1.1. të jetë i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
- 1.2. të ketë selinë në territorin e Kryeqytetit;
- 1.3. të ketë flotën prej minimum 10 (dhjetë) vetura dhe maksimum 40 (dyzet) vetura;
- 1.4. të dëshmojë se është pronar/e i/e veturave me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing) , të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe këtë rregullore, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje;
- 1.5. të ketë hapësirë parkingu për vetura në pronësi të tij/saj ose të kontraktuar;
- 1.6. të ketë numrin e vendparkimeve të njëjtë me numrin e veturave për të cilat ka licencë;
- 1.7. të ketë sistem të digjitalizuar për menaxhimin e porosive me mundësinë e zgjedhjes së shoferit/es në rastet kur kompania ka të punësuar shofere gra;
- 1.8. të ketë së paku 1 (një) veturë në çdo 10 (dhjetë) vetura të flotës të përshtatshme për persona më aftësi të kufizuara;
- 1.9. të jetë i/e pajisur me arkë fiskale, sipas vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK);
- 1.10. të jetë i/e pajisur me POS bankar në të paktën 1 (një) në çdo 10 (dhjetë) vetura të flotës;
- 1.11. të jetë i/e pajisur me certifikatën që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj) për pronarin/en dhe punëtorët;
- 1.12. të jetë i/e pajisur me certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj) për pronarin/en dhe punëtorët.

### III. VETURA ME TË CILËN KRYHET TRANSPORTI TAKSI I UDHËTARËVE

#### Neni 8

1. Vetura me të cilën kryhet transporti taksi i udhëtarëve (në tekstin e mëtejshëm *vetura taksi*), përveç kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte për t'u pajisur me certifikatë të veturës nga Kryeqyteti:
  - 1.1. të jetë me pesë (4+1) ulëse;
  - 1.2. të ketë timonin në krahun e majtë dhe të ketë së paku katër (4) dyer;
  - 1.4. viti i prodhimit të jetë jo më i vjetër se 8 vjet për licencat ekzistuese;
  - 1.5. për licencat e reja, veturat duhet të jetë hibrid dhe/apo elektrike;
  - 1.5. të jetë i pajisur me taksimetër, në gjendje të rregullt teknike, i ekuilibruar (bazhdaruar) për çdo vit, i atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër dhe i vendosur në vend të dukshëm për udhëtarin;
  - 1.6. të jenë në rregull teknikisht me klimatizim për rregullim të temperaturës (AC funksionale);
  - 1.7. vetura të jetë e pastër dhe pa dëmtime;
  - 1.8. vetura të ketë bazën ngjyrë të verdhë për taksi individual dhe të bardhë për taksi kompani;
  - 1.9. të ketë aparatin kundër zjarrit të atestuar çdo 6 muaj, të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm;
  - 1.10. vetura të jetë teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve dhe kontrolli teknik të bëhet çdo 6 muaj;

## Neni 9

1. Secila veturë që pajisjet me certifikatë të veturës nga Kryeqyteti, duhet të ketë:
  - 1.1. shenjën e unifikuar "TAXI" të vendosur mbi veturë, e cila duhet të jetë e ndriçuar me dritë sinjalizuese të gjelbër, që nënkupton se i njëjti është i lirë, dhe me dritë sinjalizuese të kuqe, që nënkupton se i njëjti është i zënë;
  - 1.2. reklamat dhe shenjat e ndryshme (me leje nga Kryeqyteti) në veturë të mos jenë mbi sipërfaqen e xhamave, në pjesën e përparme dhe të prapme të veturës, si dhe xhamat të mos jenë të errësuar;
  - 1.3. në pjesët anësore të vendosen shiritat reflektues;
  - 1.4. shenja e unifikuar "TAXI" si në pikën 1.1. të këtij neni, do të përmbajë informata sipas udhëzuesit, si p.sh. emblemën e Kryeqytetit, mbishkrimin, numrin e licencës së veturës;
  - 1.5. forma, dizajni, dimensionet dhe informatat e tjera që duhet të jenë pjesë e veturës, brenda dhe jashtë, për pikat 1.1 1.4 të këtij neni, përcaktohen nga Kryeqyteti, përmes udhëzuesit që u jepet taksive individ dhe taksive kompani;
  - 1.6. të jetë i pajisur me GPS;
  - 1.7. të ketë të vendosura rregullat e sjelljes me numrin e raportimit për siguri në vend të dukshëm për udhëtarin, sipas udhëzuesit të përgatitur nga Kryeqyteti.

## IV. DREJTUESIT (SHOFERËT) E VETURAVE TË TAKSIVE

### Neni 10

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, drejtuesit e veturës taksi duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:
  - 1.1. të kenë patentë shofer për kategorinë "B";
  - 1.2. të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë si drejtues/e i/e veturës;
  - 1.3. të mos ketë të shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit taksi të udhëtarëve më gjatë se gjashtë (6) muaj;
  - 1.4. të ketë informatat identifikuese në vend të dukshëm për udhëtarin, sipas udhëzuesit;
  - 1.5. të ketë certifikatën që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
  - 1.6. të ketë certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj);
  - 1.7. të respektojë rregullat e mirësjelljes dhe veshjes sipas legjislacionit në fuqi.

## **V. TARIFAT PËR LICENCIM**

### **Neni 11.**

1. Taksi individ pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 6 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me licencë, në kohëzgjatje për 5 vjet, me mundësi vazhdimi.
2. Taksi individ sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë licencën prej 300 Euro (5 euro në muaj për 5 vjet), të cilën shumë duhet ta paguajë në momentin e licencimit.
3. Të gjithë taksitë individë në pronësi të gjinisë femërore, të pajisura me licencë sipas pikës 1 të këtij neni, lirohen nga kjo tarifë në vitin e parë.

### **Neni 12**

1. Taksi kompani, pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 7 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me licencë, në kohëzgjatje për 5 vjet, me mundësi vazhdimi.
2. Taksi kompani, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë licencën në shumën prej 1,000 Euro (~16.667 Euro në muaj për 5 vjet), të cilën shumë duhet ta paguajë në momentin e licencimit.

## **VI. TARIFAT PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË VETURAVE TAKSI**

### **Neni 13**

1. Taksi individ pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 8 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me certifikatë të veturës, në kohëzgjatje për 1 vit.
2. Taksi individ, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë 365 euro (1 euro në ditë për 1 vit) të cilën shumë duhet ta paguajë në momentin e marrjes së certifikatës.
3. Të gjithë taksitë individë në pronësi të gjinisë femërore, lirohen nga kjo tarifë në vitin e parë.

### **Neni 14**

1. Taksi kompani, pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 8 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me certifikatë të veturës në kohëzgjatje për 1 vit, për secilën veturë që përbën flotën e tij/saj bazuar në licencën e lëshuar.
2. Taksi kompani, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë 547,50 Euro (1.5 Euro në ditë për 1 vit), për secilën veturë, të cilën shumë duhet ta paguajë në momentin e marrjes së certifikatës.

## **VII. PUNËT ADMINISTRATIVE**

### **Neni 15**

1. Punët administrative për lejjimin e ushtrimit të veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi i kryen Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP).
2. Kërkesat për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve taksi i drejtohen komisionit përkatës, të formuar me propozim të DSHPS-së dhe vendimin e kryetarit të Kryeqytetit, kërkesës i bashkëngjiten edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara sipas kësaj rregulloreje.
3. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave sipas këtij neni, DSHP jep licencën për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me vetura taksi.

### **Neni 16**

1. Taksitë individ dhe taksitë kompani për çdo ndryshim që paraqitet në rastin e ndryshimit të gjendjes teknike apo të shënimeve të tjera që ekzistojnë në licencën e ushtrimit të veprimtarisë, për veturën me të cilin ai/ajo kryen këtë veprimtari (p.sh. ndërrimi i veturës, ndryshimi i adresës së pronarit/es etj.), duhet bërë kërkesën në DSHP në afatin kohor prej shtatë (7) ditësh nga dita e paraqitjes së këtij ndryshimi.
2. Për taksitë kompani, licenca do të ndryshohet nëse ndryshohet emërtimi i kompanisë, adresa, apo bëhet ndërrimi i pronarit/es.

## **VIII. VENDQËNDRIMET - STACIONET E VETURAVE TAKSI.**

### **Neni 17**

1. Vendqëndrimi i veturave taksi është sipërfaqe publike, e destinuar për qëndrimin e veturave të taksistëve individualë.
2. Vendqëndrimi i veturave taksi individ shënohet më shenjat horizontale dhe atë vertikale të trafikut. Në shenjë vertikale shënohet emri, numri i vendqëndrimit dhe numri i vendeve.
3. Në vendqëndrime ndalohe të ketë më shumë vetura sesa që ka vende të shënuara për vetura taksi.

### **Neni 18**

1. Për mirëmbajtjen e vendqëndrimeve të veturave taksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut, kujdeset operatori ekonomik, i cili kontraktohet nga Kryeqyteti.
2. Vendqëndrimet e veturave taksi si në nenin 17 të kësaj rregulloreje, numrin, mënyrën e shfrytëzimit, do të rregullohen pas propozimit të komisionit të caktuar nga Kryeqyteti, me vendim të kryetarit të Kryeqytetit.

## **Neni 19**

1. Në vendqëndrimet për taksi, veturat vendosen sipas rendit të ardhjes.
2. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi është i/e obliguar të jetë pranë veturës së vetë gjatë kohës derisa qëndron në vendqëndrim të veturave taksi.
3. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi nuk guxon të ofrojë shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit/es dhe të fillojë transportin jashtë vendqëndrimit të veturave taksi.
4. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi mund të marrë udhëtarë jashtë vendqëndrimit të veturave taksi, në vendet ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e veturave, por vetëm më kërkesën e udhëtarit.
5. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi nuk guxon të qëndrojë, e as të marrë udhëtarë, në vendqëndrimet për transportin publik të udhëtarëve (vendqëndrimet e autobusëve, në stacionet e autobusëve).

## **IX. TRANSPORTI ME VETURË TAKSI – DREJTUESI/JA**

### **Neni 20**

1. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi obligohet të pranojë për transport secilin udhëtar në kufijtë e ulëseve që ka në dispozicion, si dhe bagazhin e udhëtarit në kufijtë e madhësisë dhe të fuqisë bartëse të hapësirës për bagazh.
2. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi është i/e obliguar të sillet me kujdes dhe në mënyrë korrekte me udhëtarët.

### **Neni 21**

1. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi është i/e obliguar që transportin ta fillojë:
  - 1.1. nga vendqëndrimi,
  - 1.2. sipas thirrjes telefonike.

### **Neni 22**

1. Transporti me veturë taksi fillon me hyrjen e udhëtarit në veturë.
2. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi obligohet që, me të hyrë të udhëtarit në veturë, të aktivizojë taksimetrin, i cili duhet të jetë në vend të dukshëm nga udhëtarit.
3. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi obligohet që transportin ta bëjë nëpër rrugët publike që kërkon udhëtarit, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër deri në vendin ku kërkon udhëtarit.
4. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi është i/e obliguar që gjatë udhëtimit të jetë i rregulluar në nivelin e duhur, duke respektuar kodin e veshjes.



## **X. KOMPENSIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE**

### **Neni 23**

1. Kompensimi për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, përcaktohet me çmime të shërbimeve dhe paguhet në shumën që tregon taksimetri në vendin e arritjes së udhëtarit.
2. Në shumën e kompensimit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarit, është llogaritur edhe transporti i bagazhit. Drejtuesi/s i/e veturës taksi është i obliguar të japë faturën për shërbimin e kryer.
3. Propozimin e çmimit nga paragrafi 1 i këtij neni, e propozon Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, kurse vendimin e merr kryetari i Komunës. Çmimorja duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm brenda veturës.

### **Neni 24**

1. Në rastin e pamundësisë së kryerjes së transportit taksi të filluar, drejtuesit/es të veturës i takon si kompensim gjysma e shumës të cilën e tregon taksimetri në momentin e ndërprerjes së transportit.
2. Drejtuesi/ja i/e veturës taksi obligohet që në rastin nga paragrafi paraprak, brenda mundësive, të sigurojë veturë tjetër për vazhdimin e transportit të udhëtarëve deri në vendin e caktuar nga udhëtarët.
3. Për pranimin e udhëtarëve të tjerë gjatë transportit deri te vendi i përcaktuar, vendos udhëtarin/ja i/e cili/a ka filluar shfrytëzimin e transportit taksi, me pëlqimin e drejtuesit/es të veturës taksi.
4. Nëse udhëtarin/ja i/e cili/a është pranuar gjatë udhëtimit vazhdon shfrytëzimin e transportit taksi edhe pas vendit të përcaktuar të udhëtarit i cili ka filluar shfrytëzimin e transportit taksi, vazhdimi i udhëtimit deri në distancën 100m nuk konsiderohet si fillim i shfrytëzimit të transportit taksi.

### **Neni 25**

1. Me veturë taksi nuk mund të transportohen:

- 1.1. fëmijët nën moshën tetëvjeçare (8) pa përcjellës, përveç nëse prindi apo kujdestari lidh marrëveshje me shkrim me drejtuesin/en e taksisë individual ose me pronarin/en e kompanisë për taksi kompani, të cilit/es i është besuar fëmija për ta transportuar deri në vendin e caktuar;
- 1.2. personat në ndikim të alkoolit në ulëset e përparme të veturës, në ndikim të drogës dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse;
- 1.3. personat të cilët me veshmbathjen e vet do të dëmtonin apo ndotin brendinë e veturës;
- 1.4. kufomat;
- 1.5. kafshët e ngordhura;
- 1.6. materiet e rrezikshme: eksplozuese, radioaktive, helmuese, infektive, ato që ndizen lehtë dhe materie të tjera të cilat për shkak të vetive të veta mund të paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, apo mund të shkaktojnë dëmtime të tjera, si dhe armët e ftohta dhe armët e zjarrit.

## **XI. NDËRPRERJA E PËRKOSSHME E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE**

### **Neni 26**

1. Taksi individual i cili ushtron veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, mund të ndërpresë ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, në kohën e:
  - 1.1. shfrytëzimit të pushimeve të parapara sipas ligjeve në fuqi;
  - 1.2. aftësimin profesional ose kryerjes së funksionit publik;
  - 1.3. riparimit të veturës me të cilin ushtron veprimtarinë e transportit taksi të udhëtarëve, në kohëzgjatje prej 30 ditësh gjatë vitit kalendarik;
  - 1.4. paraburgimit ose vuajtjes së dënimit me burg, në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj, si dhe për kohën sa zgjat procedura e hetuesisë, përkatësisht masa e ndalimit të drejtimit të veturës.
  - 1.5. Kërkesën për ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të veprimtarisë, personi fizik ia parashtron drejtorisë kompetente, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e paraqitjes së rrethanave nga nenet paraprake.
  - 1.6. Pas kërkesës nga paragrafi 1.5. i këtij neni, drejtuesi i taksisë menjëherë është i obliguar të kthejë licencën për ushtrimin e veprimtarisë, e cila do të mbetet në drejtori për aq kohë sa zgjat masa e përkohshme.
  - 1.7. Drejtuesi i taksisë është i obliguar që të rifillojë punën në afat prej tri (3) ditësh nga dita e ndërprerjes së arsyeve për të cilat është lejuar ndërprerja e përkohshme e ushtrimit të veprimtarisë.

## **XII. NDËRPRERJA DHE REVOKIMI I LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE**

### **Neni 27**

1. Taksi individual e ndërpre në veprimtarinë:
  - 1.1. me kërkesë për çregjistrim për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve;
  - 1.2. me paraqitjen e rrethanave, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të kësaj rregulloreje;
  - 1.3. me rastin e vdekjes së ushtruesit të veprimtarisë.

### **Neni 28**

1. Taksi individual në rast të ndërprerjes së veprimtarisë, obligohet t'i kthejë licencën dhe certifikatën e veturës për ushtrimin e kësaj veprimtarie drejtorisë kompetente.

2. Veprimtaria për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve ndërpritet me fshirjen nga regjistri i taksistëve aktiv, por mbetet në regjistër historik.

### Neni 29

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve humb vlerën kur:

- 1.1. operatori falimenton (nëse vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente);
- 1.2. mbaron afati i vlefshmërisë së saj;
- 1.3. kërkohet nga mbajtësi i saj;

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve hiqet nga Drejtoria e cila e lëshon atë, kur:

- 2.1. vërtetohet se operatori ka humbur njërën nga kushtet e përcaktuara me nenet 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, me rastin e inspekimit;
- 2.2. vërtetohet se mbajtësi i licencës shkel detyrimet e përcaktuara me këtë rregullore, me rastin e inspektimit;

3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, i hiqet në mënyrë të përhershme atij operatori që është dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e veprës penale për kontrabandim me narkotikë dhe trafikim të qenieve njerëzore.

4. Vendimi merret nga drejtoria kompetente që ka lëshuar licencën, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit sipas kësaj rregulloreje.

5. Drejtoria e Inspeksionit mund të iniciojë revokimin e licencës në rast se personi përgjegjës i personit juridik dhe personi fizik, bëjnë përsëritje disa herë të shkeljeve ( kundërvajtjeve).

## XIII. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

### Neni 30

1. Pronari/ja i/e veturës taksi, i/e cili/a nuk ka licencë për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve me shenjën unifikuese "TAXI", përjashtohet nga trafiku nga inspektori ose nga punëtori i autorizuar i policisë dhe i merren targat e veturës, në kohëzgjatje nga 48 orë deri në 5 (pesë) ditë. Kthimi i targave të veturës, bëhet pas pagesës së gjobës mandatore.

2. Vendimi për përjashtimin e veturës taksi nga trafiku, i dorëzohet drejtuesit aty për aty. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara për shkak të zbatimit të dispozitës nga paragrafi paraprak i këtij neni, në tërësi i bart drejtuesi i veturës.

3. Hyrja në veturë dhe dalja e udhëtarëve nga vetura taksi, nuk mund të bëhen në vendqëndrimet e autobusëve.

4. Kur drejtuesi/ja i/e veturës taksi nuk kryen transportin taksi të udhëtarëve, përkatësisht kur përdor veturën taksi për nevoja të veta, është i obliguar që të heqë shenjën "TAXI" nga vetura.

5. Veturat taksi, të regjistruara për transportin taksi të udhëtarëve në territorin e komunave të tjera, mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në territorin e Kryeqytetit, në rastin kur sjellin udhëtarë nga

komunat tjera. Gjatë kthimit ata mund t'i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë, por nuk lejohen të marrin udhëtarë të rinj.

6. Me veturën taksi nuk mund të transportohet numër më i madh i udhëtarëve nga numri i ulëseve të regjistruara në veturë, e as që mund të vendoset më vonë numër më i madh i ulëseve nga ato të regjistruara.

7. Të gjithë taksitë e licencuar janë të obliguar t'i paraqesë inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijojë atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

8. Transporti i udhëtareve me taksi në linjën e rregullt është i ndaluar.

## **Inspektimi në transportin rrugor**

### **Neni 31**

Punët e inspektimit në transportin taksi të udhëtarëve brenda territorit të komunës, i bëjnë inspektorët, bazuar në këtë rregullore, dhe Policia e Kosovës në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj.

## **Autorizimet e inspektorit të transportit rrugor**

### **Neni 32**

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori është i autorizuar:

- 1.1. të bëjë inspektimin dhe kontrollimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve lidhur me veprimtarinë e tyre, në pajtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- 1.2. të bëjë inspektimin dhe kontrollimin e të gjitha veturave dhe ekuipazhit të transportit rrugor të udhëtarëve, si dhe dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor;
- 1.3. të përjashtojë veturën nga qarkullimi deri në dyzetetë (48) orë, në qoftë se konstaton se operatori është duke kryer transportin rrugor të udhëtarëve në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore;
- 1.4. që në rast se inspektori shqipton masën e dënimit të njëjtit operator për herë të dytë për shkaqet e përcaktuara, vetura do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në pesë (5) ditë;
- 1.5. që me rastin e përjashtimit të veturës auto - taksi, t'i marrë shenjën "Taxi" dhe lejen përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë;
- 1.6. që me rastin e përjashtimit të veturës nga qarkullimi, të marrë vendim që vetura e ndaluar të dërgohet në vend të caktuar, në shpenzime të mbajtësit të licencës, dhe nëse është e domosdoshme, lidhur me këtë mund të kërkojë ndihmën e policisë së Kosovës;
- 1.7. të urdhërojë operatorin për eliminimin e parregullsive në transportin rrugor të udhëtarëve;
- 1.8. të fillojë iniciimin e procedurës pranë gjykatës kompetente, kur konstaton se operatori i transportit rrugor të udhëtarëve ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit ose të kësaj rregulloreje;
- 1.9. të nxjerrë vendim për:
  - ndalimin e përkohshëm, sipas nënparagrafit 1.3. të këtij neni ;
  - përjashtimin e veturës nga qarkullimi, sipas nënparagrafit 1.4. të këtij neni;

- eliminimin e parregullsive, sipas nënparagrafit 1.5. të këtij neni.
- 1.10. Inspektorët, në mënyrë periodike, bëjnë verifikimin e kushteve të licencës së operatorëve të transportit;
- 1.11. Inspektori mund të iniciojë procedurë për revokimin e licencës nëse operatori përsërit shkeljet kundërvajtëse.

#### **XIV. DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

##### **Gjobat**

##### **Neni 33**

1. Operatori taksi, përkatësisht personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, për kundërvajtje do të ndëshkohet me gjobë prej 100 euro, ndërsa personi juridik për kundërvajtje do të dënohet me gjobë prej 1,000 euro nga Inspektori i komunës:
- 1.1. nëse vepron në kundërshtim me nenin 3 të kësaj rregulloreje;
  - 1.2. nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 të kësaj rregulloreje;
  - 1.1. nëse vepron në kundërshtim me nenin 5 të kësaj rregulloreje;
  - 1.2. nëse vepron në kundërshtim me nenin 6, të kësaj rregulloreje;
  - 1.3. nëse vepron në kundërshtim me nenin 7, të kësaj rregulloreje;
  - 1.4. nëse vepron në kundërshtim me nenin 8, të kësaj rregulloreje.
  - 1.5. nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje;
  - 1.6. nëse vepron në kundërshtim me nenin 10 të kësaj rregulloreje;
  - 1.7. nëse vepron në kundërshtim me nenin 11, të kësaj rregulloreje;
  - 1.8. nëse vepron në kundërshtim me nenin 12, të kësaj rregulloreje;
  - 1.9. nëse vepron në kundërshtim me nenin 13, të kësaj rregulloreje;
  - 1.10. nëse vepron në kundërshtim me nenin 14 të kësaj rregulloreje;
  - 1.11. nëse vepron në kundërshtim me nenin 16 të kësaj rregulloreje;
  - 1.12. nëse vepron në kundërshtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje;
  - 1.13. nëse vepron në kundërshtim me nenin 19 të kësaj rregulloreje;
  - 1.14. nëse vepron në kundërshtim me nenin 20 të kësaj rregulloreje.
  - 1.15. nëse vepron në kundërshtim me nenin 21 të kësaj rregulloreje.
  - 1.16. nëse vepron në kundërshtim me nenin 22 të kësaj rregulloreje;
  - 1.17. nëse vepron në kundërshtim me nenin 23 të kësaj rregulloreje;
  - 1.18. nëse vepron në kundërshtim me nenin 24 të kësaj rregulloreje;
  - 1.19. nëse vepron në kundërshtim me nenin 25 të kësaj rregulloreje;
  - 1.20. nëse vepron në kundërshtim me nenin 26, të kësaj rregulloreje;
  - 1.21. nëse vepron në kundërshtim me nenin 28, të kësaj rregulloreje;
  - 1.22. nëse vepron në kundërshtim me nenin 29 të kësaj rregulloreje;
  - 1.23. nëse vepron në kundërshtim me nenin 30 të kësaj rregulloreje.

2. Për kundërvajtje të njëjta që operatori, përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

#### **XIV. PROCEDURA E ANKESËS**

##### **Neni 34**

1. Kundër vendimit të lëshuar nga inspektori, mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të aktit administrativ.

#### **XV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

##### **Neni 35**

1. Procedura, sipas kërkesës për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, që ka filluar e nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Të gjithë operatorët të cilët janë të pajisur me licencë, në kohëzgjatje prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, obligohen t'i plotësojnë kriteret e specifikuar në të.

##### **Neni 36**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, 01 nr. 344 - 3707, dt. 31.1.2012, Vendimi nr. 01 nr.346/03-00220334/07.02.2017 dhe të gjitha vendimet të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore.

##### **Neni 37**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-346/02-257624/22, më 25.11.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina

